



18-25 MAJ

JAVA E MBROJTJES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

SHQIPËRIA MIKPRET STËRVITJEN “DEFENDER EUROPE 25”

Prej 25 majit Shqipëria do të mirëpresë stërvitjen ushtarake shumëkombëshe **Defender Europe 25**, e drejtuar nga Komanda Evropiane e SHBA-së (**USEUCOM**). Forcat e NATO-s dhe **partnerët** e saj do të ushtrohen në Shqipëri dhe Kosovë, duke përfshirë mbrojtjen e **objekteve** kritike, operacione **sulmuese** dhe mbrojtëse, si dhe sigurimin e pikave kyçe të dislokimi

★★★★★

mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

KOMANDANTI I FSK NË TIRANË

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, priti në një takim zyrtar komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant **Bashkim Jashari**. I pranishëm në këtë takim ishte edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të **FA-së**, gjenerallejtënant **Arben Kingji**. Në takim u diskutua mbi bashkëpunimin strategjik ndërmjet dy vendeve në fushën e Mbrojtjes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

Albanian Defense and Security College
WELCOME
to the closing ceremony of Senior Course
in Security and Defense Studies
SCSDS-15
23 May 2025

PËRFUNDON KURSI I LARTË I XV I KLSM

Ushtarakë të lartë nga Shqipëria, Kosova, Kroacia, Gjeorgjia, Hungaria, Italia, Turqia si dhe civilë **profesionistë** nga **institucionet** e ndryshme të sigurisë në vend përfunduan me sukses Kursin e Lartë të **Sigurisë** dhe Mbrojtjes që zhvillohet pranë **Kolegjit** të Mbrojtjes dhe Sigurisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

SHQIPËRIA, NË STËRVITJEN “CYBER YANKEE 2025”

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike (NJUSK) nga Shqipëria mori pjesë me sukses në stërvitjen e përvitshme ndërkombëtare "Cyber Yankee 2025", e cila u zhvillua në Qendrën e Trajnimit Edward Cross në New Hampshire, SHBA, nga 5 - 16 maj 2025. Stërvitja u organizua nga Gardat Kombëtare të shteteve të New England dhe New Jersey.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

STËRVITJE E PËRBASHKËT E NATO-S NË ADRIATIK

Në kuadër të “Operation Sea Guardian”, u zhvillua operacioni i fokusuar 25-3, duke theksuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet aleatëve të NATO-s. Anija shqiptare Lissus dhe ajo kroate HRV Vukovar realizuan një stërvitje të përbashkët (PASSEX) në ujërat jugore të Adriatikut, me synim forcimin e ndërveprimit dhe gatishmërisë detare.



mod.gov.al

JM

XHENIOT PËRMIRËSOJNË SIGURINË NË BAZËN E PASHALIMANIT

Batalioni i Xhenios ka përfunduar me sukses punimet në Bazën Detare të Pashalimanit, duke zhvendosur rrugën e mjeteve civile jashtë garnizonit dhe duke rritur ndjeshëm sigurinë. 19 efektivë dhe 10 mjete teknike nga batalioni u angazhuan në bashkëpunim me repartin e Pashalimanit, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe garantimin e një mjedisi më të sigurt.

★★★★★

ANIJA “BUTRINTI” SHPËTON 13 EMIGRANTË NË DETIN EGJE

Anija shqiptare “Butrinti” P-134, pjesë e misionit të NATO-s në Detin Egje, përfundoi me sukses një operacion kërkim-shpëtimi, duke ndihmuar 13 emigrantë, përfshirë 2 fëmijë. Operacioni u zhvillua në bashkëpunim me rojet bregdetare të Greqisë dhe Turqisë dhe përfundoi pa incidente. Ky është operacioni i katërt SAR i Forcës Detare shqiptare në Egje gjatë vitit 2025, me 111 jetë të shpëtuara.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

SNAJPERISTËT SHQIPTARË FITOJNË MEDALJEN E BRONZTË NË TURQI

Efektivët e Batalionit të Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) u renditën të tretët në garën ndërkombëtare “Best Sniper Team Competition” në Isparta, Turqi, nga 5 deri më 15 maj 2025. Në garën me 26 ekipe nga 18 vende, operatorët shqiptarë treguan profesionalizëm dhe precizion, duke përfaqësuar denjësisht Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe duke forcuar imazhin e vendit në sigurinë ndërkombëtare.

★★★★★